




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: ISP Broadcast SH.P.K
Emri Tregtar: ISP BROADCAST
Numri Unik Identifikues: 810011643
Pronar: Qëndrim Kryeziu
Operatori i Shpërndarjes: ISP BROADCAST
Adresa: Rr/Gjergj Balshaj, pn, Malishevë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës së KPM-së për operatorin e shpërndarjes ISP BROADCAST, me seli në Malishevë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ISP Broadcast është operatorë i shpërndarjes, me pronarin Qëndrim Kryeziu i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Malishevë. KPM, me datën 30 tetor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes ISP Broadcast.
3. Me datën 30 tetor 2023, skadon afati i licencës së OSH ISP Broadcast, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mailit, ju ka dërguar shkresë të gjithë Operatorëve të Shpërndarjes të cilave afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe operatorit ISP Broadcast, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj, në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisioni i Pavarur të Mediave.
5. Më datën 30 qershor 2023, operatori i shpërndarjes ISP Broadcast ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në përcakton: *“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*
7. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM ka njoftuar operatorin e shpërndarjes ISP Broadcast lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës, ndërsa përmes e-mail-i është njoftuar lidhur me dokumentacionin shtesë të nevojshëm.
8. Komisioni konstaton se operatori i shpërndarjes ISP Broadcast, përmes kërkesës me shkrim, ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuele.
9. Komisioni konstaton se ISP Broadcast ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
10. Komisioni konstaton se, sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së ISP Broadcast, ku figuron emri i pronarit sipas licencës z. Qëndrim Kryeziu.
11. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga operatorit të shpërndarjes ISP Broadcast të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
12. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes ISP Broadcast është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së ISP Broadcast i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon.

Vendim

13. Komisioni, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes ISP Broadcast, për të ushtruar veprimtarinë e shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale në Republikën e Kosovës.
14. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes ISP Broadcast do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 30 tetor 2023.

15. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes ISP Broadcast, si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbasin të pandryshuara nga licenca paraprake.

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



10.11.2023

Datë